

VENDIM
Nr. 542, datë 29.7.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 179, DATË 26.2.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR RREGULLAT, KUSHTET DHE PROCEDURAT E
PRIVATIZIMIT TË BANESAVE QË KANË QENË SUBJEKT I LIGJIT NR. 7652,
DATË 23.12.1992, ‘PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE SHTETËRORE’, DHE TË
LIGJIT NR. 9321, DATË 25.11.2004, ‘PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE DHE
OBJEKTEVE TË KTHYERA NË BANESA, TË NDËRTUARA ME FONDET E
SHOQËRIVE DHE TË NDËRMARRJEVE SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, shkronja “a”, e 3, të nenit 77, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 31 e vendimit nr. 179, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“31. Privatizimi i banesave, sipas këtij vendimi, ka afat 2 (dy) vjet pas daljes së certifikatës së pronësisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama